




Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d), nenit 51, paragrafi 51.1, nenit 53, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 8 dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme, nenit 15, paragrafi 15.1, nenit 26, pika 26.1 dhe nenit 28 të Statutit të Komunës së Ranillugut nr. 02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut, në mbledhjen e parë të rregullt të mbajtur më 30.01.2026, ka miratuar:

V E N D I M P Ë R FORMIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1.

Propozimi i paraqitur ka kaluar shqyrtimin kryesor në mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut, të mbajtur më 30.01.2026, ku është aprovuar dhe miratuar me shumicë votash.

2.

Me këtë vendim formohet Komiteti për Komunitete nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve:

1. Bojan Stamenković, anëtar i Kuvendit (Lista Serbe);
2. Marko Nikolić, anëtar i Kuvendit (Lista Serbe);
3. Millena Artonović, anëtare e Kuvendit (Lista Serbe);
4. Qemal Dubova, komuniteti shqiptar;
5. Xhevahire Dubova, komuniteti shqiptar;
6. Fatime Maloku, komuniteti shqiptar;
7. Yll Arifi, komuniteti shqiptar.

3.

Detyrat e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me nenin 53, paragrafi 2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme.

4.

Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete përfundon me përfundimin e mandatit aktual të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

5.

Kryesuesi i Komitetit zgjidhet me shumicë votash të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës.

Data: 30.01.2026

Ranillug



Kryesues i KK së Ranillugut

Ivan Krstiq